



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 744/4 Prot

Tiranë, më 22.09.2021

V E N D I M

Nr. 111, datë 22.09.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë të aktit nr. 88 (nr. 6029/7 prot.), datë 21.7.2021, të Komisionit të disiplinës të Bashkisë Durrës, për dhënien e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, ndaj nëpunëses *** , me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me pretendimet e ngritura nga nëpunësja ***** , për procedim disiplinor të padrejtë dhe dhënien e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, nga Komisioni i disiplinës të Bashkisë Durrës,

VËREJ SE:

Me anën e ankesave të regjistruara pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 744 prot., datë 16.7.2021, nr. 744/1 prot., datë 21.7.2021 dhe nr. 744/2 prot., datë 30.7.2021, nëpunësja ***** , me detyrë ish “Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”, në Bashkinë Durrës, ka parashtruar pretendime në lidhje me ligjshmërinë e zhvillimit të një ecurie disiplinore ndaj saj, proces që është përmbyllur me vendimin nr. 88 (nr. 6029/7 prot.), datë 21.7.2021, të Komisionit të disiplinës të Bashkisë Durrës, nëpërmjet të cilit është vendosur largimi i saj nga shërbimi civil.

Për verifikimin paraprak të këtij rasti, u kërkua nga Bashkia Durrës i gjithë materiali shkresor që pasqyron veprimet administrative të kryera gjatë këtij procedimi disiplinor. Këto materiale janë dërguar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Durrës në mënyrë elektronike, me email datë 10.9.2021.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit që pasqyron gjithë veprimet administrative që janë kryer gjatë këtij procedimi disiplinor, që nga momenti i konstatimit të shkeljes disiplinore (nga kërkesa e drejtuesit të bashkisë nr. 4785 prot., dt. 8.5.2020, drejtuar Sektorit të Protokoll Arkivës, për informacion në lidhje me gjithë korrespondencën/shkresat që kanë hyrë në protokollin e Bashkisë Durrës, gjatë periudhës dhjetor 2019 - maj 2020, që i ishin adresuar për t'u trajtuar Drejtorisë të Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe që nuk ishin trajtuar prej saj), e deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga organi disiplinor, (vendim nr. 88 (nr. 6029/7 prot.), datë 21.7.2021, i Komisionit të Disiplinës të Bashkisë Durrës), rezultoi e provuar si më poshtë:

Ankuesja ******, pas kryerjes së procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 417, datë 22.10.2019 (nr. 17352 prot., datë 22.11.2019), të kryetarit të Bashkisë Durrës është emëruar nëpunës civil, në pozicionin “Drejtore në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”, në administratën e Bashkisë Durrës. Konstatohet që për nevoja të institucionit, me aktin nr. 622 (14069 prot.), datë 18.11.2020, ajo është transferuar përkohësisht, në detyrën “Drejtore në Drejtorinë e Turizmit, Politikave të Zhvillimit dhe Integritit Europian” dhe më pas, me aktin nr. 86 (nr. 8094 prot.), datë 7.7.2021, është rikthyer në pozicionin e mëparshëm “Drejtore në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”, ku kishte emërimin e rregullt në shërbimin civil.

Shkelja disiplinore e pretenduar, është konstatuar nga drejtuesi i bashkisë, i cili me shkresën nr. 4785 prot., dt. 8.5.2020, i ka kërkuar Sektorit të Protokoll Arkivës, një informacion për të gjithë korrespondencën/shkresat që kishin hyrë në protokollin e Bashkisë Durrës, përgjatë periudhës dhjetor 2019 - maj 2020 dhe që i ishin adresuar për zgjidhje Drejtorisë të Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, ku ankuesja kryente detyrën e drejtorit.

Nga verifikimi i kryer në këtë rast, pretendohet se një numër i konsiderueshëm i korrespondencës, adresuar drejtorisë së ankueses, nuk kishin marrë një përgjigje për mënyrën e zgjidhjes së tyre, megjithëse kishte kaluar çdo afat ligjor. Këtë situatë, drejtuesi i institucionit e ka konsideruar si shkelje shumë të rëndë disiplinore të parashikuar nga shkronja “b”, pika 2, e nenit 57, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e për këtë arsye me shkresën nr. 4785/2 prot., datë 14.5.2020, i ka kërkuar Komisionit të disiplinës të Bashkisë Durrës, fillimin e ecurisë disiplinore për nëpunësen *****.

Komisioni i disiplinës, është ngritur fillimisht, me urdhrin nr. 144 (4901 prot.), datë 11.5.2020, të drejtuesit të Bashkisë. Më pas ky organ kolegjal ka ndryshuar përbërjen sipas

urdhrave nr. 148 (4901 prot.), dt. 15.5.2021 dhe nr. 298 (6029 prot.), dt. 19.5.2021. Procesi disiplinor ka zgjatur në kohë, për disa arsye si, gjendja shëndetësore e ankuses, për një periudhë tre mujore, të provuar me raportet mjekësore përkatëse; situatës së pandemisë të shkaktuar nga COVID-19; si dhe, pritjes së konkluzioneve nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në lidhje me një ankesë të bërë nga punonjësja.

Së fundi, Komisioni i disiplinës në mbledhjen e datës 21.7.2021, pasi ka shqyrtuar shkeljen disiplinore të pretenduar për punonjësën ******, në përfundim të diskutimeve ka arritur në konkluzionin se ajo ka kryer shkelje shumë të rënda disiplinore, të parashikuar nga pika 2/c, e nenit 57, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Me këtë motivacion, në përfundim të procedurës, nëpërmjet aktit administrativ nr. 88 (nr. 6029/7 prot.), datë 21.7.2021, Komisioni ka vendosur marrjen e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, ndaj punonjësës në fjalë, duke arsyetuar në përmbajtjen e tij rrethanat dhe faktet mbi të cilat është bazuar vendimi, sipas kërkesave të neneve 99 e 100, të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenit 59 e 60, të ligjit për nëpunësin civil.

Më tej, në zbatim të pikës 20, kreu II, “Procedura disiplinore”, të vendimit nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”, i ndryshuar, vendimi për marrje mase disiplinore i është njoftuar rregullisht, punonjësës *****.

Ndërkohë, gjatë komunikimit në mënyrë elektronike me Bashkinë Durrës konstatohet fakti që, punonjësja ******, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, me kërkesë padi me objekt anullimin e aktit administrativ nr. 88, datë 21.7.2021, vendim i Komisionit të disiplinës të Bashkisë Durrës, për dhënien e masës disiplinore, largim nga shërbimi civil ndaj saj. Nga aktet e vëna në dispozicion rezulton se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës nëpërmjet njoftim aktesh, nr. 2150, të regjistruar në Bashkinë Durrës me nr. 6029/9, datë 5.8.2021, i ka njoftuar institucionit të Bashkisë Durrës padinë dhe aktet shoqëruese të saj, duke i caktuar një afat 10 ditë për dorëzimin e prapësimeve dhe akteve të plota shkresore, në të cilat janë bazuar për kryerjen e veprimit administrativ.

Nisur nga gjithë sa më sipër dhe bazuar në parimin e sanksionuar në nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, sipas të cilit institucionet e tjera nuk mund të trajtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, vlerësojmë se në këtë rast, nuk duhet të vijojë më tej hetimi administrativ, pasi mosmarrëveshja do të zgjidhet përfundimisht nga gjykata, e cila do të vendosë edhe për zgjidhjen e pasojave të aktit.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ filluar në bazë të informacionit të punonjësës ***** , të regjistruar me nr. 744 prot., datë 16.7.2021, nr. 744/1 prot., datë 21.7.2021 dhe nr. 744/2 prot., datë 30.7.2021, në lidhje me masën disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, të marrë ndaj saj me vendimin nr. 88 (nr. 6029/7 prot.), datë 21.7.2021, të Komisionit të disiplinës të Bashkisë Durrës dhe arkivimin e çështjes, pasi çështja do të zgjidhet në mënyrë përfundimtare nga Gjykata.
2. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Durrës, Njësia Përgjegjëse dhe nëpunësja *****.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha